



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 125, datë 28.10.2021

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB 104, DATË 31.08.2021 “PËR NJË SHTESË NË VKB NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME MIRATIMIN E TARIFËS SË UJIT PËR UJITJE

Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” , VKM-së nr.993, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Ndërmarrja Rruga, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në VKB-në nr.104, datë 31.08.2021 “Për një shtesë në VKB-në nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, në lidhje me tarifën e ujit për ujitje, si më poshtë vijon:

TARIFA E UJIT PËR UJITJE

Nr.	Kategoria	Njësia
	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë/dynym/nr.ujitje

2. Miratimin e një shtese në VKB-në nr.104, datë 31.08.2021 “Për një shtesë në VKB-në nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, në lidhje me tarifën e mirëmbajtjes së infrastrukturës, si më poshtë vijon:

Nr.	Kategoria	Njësia
	Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës	0.0557 lekë

3. Miratimin e riformatimit të Tabelës nr.42, si pjesë përbërëse e Vendimit nr.127, datë 14.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, si më poshtë :

TABELA NR. 42

TARIFA E UJIT PËR UJITJE DHE TARIFA E MIRËMBAJTES SË INFRASTRUKTURËS

Nr.	Kategoria	Njësia
1.	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë dynymi për nr.ujitje
2.	Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës	0.0557 lekë



4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ndërmarrja Rruga.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2021






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. ~~868~~ / 2 prot.



Durrës, më 05/11/2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërise së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.125 datë 28.10.2021: Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 104 datë 31.08.2021 “Për një shtesë në VKB Nr 127 datë 24.12.2020 për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021 në lidhje me miratimin e tarifës së ujit për ujitje”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

